- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

### **Neni 24 Pranimi përfundimtar**

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **Neni 25 Shkelja e kontratës**

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpermendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

### **Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytësore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbytësor brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në

rregulloret nacionale;

- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Nderprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta përmblyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rëxhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

### Neni 27 Nderprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Nderprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

### Neni 28

### Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëujma, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me

kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

### Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## **PJESA III E KONTRATËS      KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.





Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Komunikimet dhe Gjuha e përdorur	2.2	<p>Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe. Komunikimi mes Autoritetit Kontraktues dhe kontraktuesit do të bëhet vetëm përmes përfaqësuesve të palëve nënshkruese apo personave të autorizuar nga palet nënshkruese të kësaj kontrate.</p> <p>Kudo që këto Kushte sigurojnë dhënie apo lëshimin e aprovimeve, çertifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve dhe kërkesave, këto komunikime do të jenë:</p> <p>(a) me shkrim dhe të dërgohen me dorë (përkundër dëftesave), të dërgohen përmes postës apo korerit, ose të trasmetohen duke përdorur me pajtım çfardo sistemesh të transmetimit elektronik; dhe</p> <p>(b) të dërgohen, çohen apo trasmetohen në adresën për komunikimet e pranuesit siç është shpallur në Kontratë. <b>Sidoqoftë:</b></p> <p>(c) nëse pranuesi njofton për një adresë tjetër, komunikimet që andej e tutje duhet të dërgohen në përputhje me rrethanat; dhe</p> <p>(d) nëse pranuesi nuk e ka shpallur ndryshe kur ka kërkuar një aprovim apo pëlqim, mund të dërgohet në adresën prej së cilës është lëshuar kërkesa..</p> <p>Aprovimet, çertifikatat, pëlqimet dhe përcaktimet nuk duhet të mbahen apo vonohen pa arsye.</p> <p>Kontraktuesi nuk duhet që, pa pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktues , të anuloj caktimin e Përfaqësuesit të Kontraktuesit – personin e autorizuar apo të bëj një zëvendësim.</p> <p>Përfaqësuesi i Kontraktuesit duhet që, në emër të Kontraktuesit, të pranoj udhëzimet sipas kësaj kontrate</p> <p>Përfaqësuesi i Kontraktuesit mund të delegoj çfardo fuqie, funksioni dhe autoriteti cilido personi kompetent dhe mund që gjatë çfardo kohe të anuloj delegimin. Çfardo delegimi apo anulimi nuk do të hyjë në fuqi derisa autoriteti kontraktuae të ketë marrë njoftim paraprak të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Kontraktuesit, duke emëruar personin dhe specifikuar fuqit, funksionet dhe autoritetin e deleguar apo të anuluar.Përfaqësuesi i Kontraktuesit dhe të gjithë këta persona duhet të jenë të rrjedhshëm në gjuhën për komunikimet e definuara në kete kontrat .</p>
Obligimet Kontraktuesit	c 2,3	<p>Kontraktuesi do t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, Ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtım paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Nëse shfaqet ndonjë mosmarrëveshje lidhur me nevojën për publikim ose shpalosje për qëllime të kontratës, vendimi i Autoritetit kontraktues do të jetë final.Të gjitha furnizimet duhet t'i kryej konform specifikimeve teknike dhe çmimorës si dhe obligimet tjera që janë specifikuar në dosje të tenderit.</p>
Programi i realizimit	2.4	<p>Institucionet e komunës nëpërmes <b>Kryetarit të komunës</b> obligohet që të caktojnë Menaxher të projektit personin me përvojë dhe mundësisht nga Institucionet e komunës duhet të hartojnë Planin e menaxhimit të kontratës konform nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për mbikqyrjen dhe raportimin për furnizimet e kryera.</p>
Menaxhimi	2.5	<p>Menaxheri i caktuar ka për obligim që OE furnizues ta përcjellë realizimin e kontratës dhe kryerjen e furnizimeve ashtu është precizuar në dosjen e tenderit.</p>
Siguria e ekzekutimit	8.1	<p>Shuma e sigurise se ekzekutimit është <b>10 % e shumës së vlerës së Kontratës</b> dhe do të jetë valid <b>25 muaj</b>. Siguria e ekzekutimit duhet të ofrohet nga OE në ditën e hyrjes në fuqi së kontratës.</p> <p>Kontraktuesi duhet te përfundoj furnizimet sipas datës se paraparë ne nenin paraprak ne afat deri me <b>29.08.2025 (24 muaj)</b> dhe te dorëzoj raportin përfundimtar te furnizimeve të kryera në në fund të çdo muaji ku duhet te përmbahen te gjitha detajet për furnizimet e kryera dhe Organin Mbykqyres me nje Vendim tjetet.</p>

Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	8.2	<p>Kreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jënë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Mjetet motorike të Palës së Tretë: sipas ligjeve në fuqi</li> <li>Përgjegjësia e pales së tretë sipas ligjeve në fuqi</li> <li>Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve sipas ligjeve në fuqi</li> <li>Përgjegjësia profesionale sipas ligjeve në fuqi</li> <li>Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve sipas ligjeve në fuqi</li> </ol> <p>Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit që ne baze të kontrates i takojnë Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë <b>përgjegjësi të plotë</b>, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe DKA nga ankesat dhe dëmet tjera të shkaktuara nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.</p>
Pagesat	8.3	<p>Për t'i marrë pagesat, Kontraktuesi duhet t'i përcjellë Autoritetit të përmendur në paragrafin 26.1 më lart:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Kontraktuesi obligohet që për furnizimet e kryera në muajin e kaluar, Faturën ta dorëzoj nga data <b>01 deri 05</b> e muajit në vazhdim ose në <b>momentin e kryejrjes së furnizimeve</b>.</li> <li>Pagesa duhet të kryhet mundësisht menjëherë, nëse jo atëherë jo më vonë se <b>tridhjetë ditë</b> pas dorëzimit dhe pranimit të faturës.</li> </ol>
Sigurimi	9.1	<p>OE obligohet që Furnizimet me <b>Kabineti ne SHFMU D. Drenices, SHMP F.Lladrovci, D.Fortesa, Sh.Polluzha, M.S.Bytyqi - Projekt dy vjeqarta</b> siguroj gjate bartjes dhe transportit deri ne dorzimin final.</p>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<p><b>Kabineti ne SHFMU D. Drenices, SHMP F.Lladrovci, D.Fortesa, Sh.Polluzha, M.S.Bytyqi - Projekt dy vjeqar</b>-Kontratë Kornizë për DY vite duhet te jete i perafert ashtu si shkruan ne specifikacionin e prodhuesit. . Furnizimet duhet të kryhen Konform standardeve të kërkuara në dosje të tenderit. Nëse furnizimet janë të dobëta dhe pas tërheqjes së vërejtjes ato përseri janë të tilla, atëherë fillohet me uljen e pagesave mujore dhe nëse prapë vazhdohet atëherë kontrata njëanshëm ndërpritet.</p>
Inspektimi dhe testimi	17.2	<p>Çdo herë para se te pranohet apo sipas nevojave.</p>
Dorëzimi	19.3	<p><b>Kabineti ne SHFMU D. Drenices, SHMP F.Lladrovci, D.Fortesa, Sh.Polluzha, M.S.Bytyqi - Projekt dy vjeqar</b> -Kontratë Kornizë për DY vite.duhet te jene te pakeluar dhe te bashkangjitur me specifikimet dhe udhezimet nga prodhuesi dhe të dorëzohet te Depoisti Komunal ).</p>
Obligimet e garancionit	22.1	<p>Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, me afat te perdorimit. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.</p>
Obligimet tjera të kontraktuesit	22.5	<p>Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit që ne baze të kontrates i takojnë Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Zyrtarin e prokurimit nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Kontraktuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.</p>
Dëmet e likuiduara	22.6	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Furnizimet janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Furnizimet është 10 % e Çmimit final të Kontratës. e. Furnizimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 ditë pas pranimit të kërkesës nga Njësia kërkuese.</p>
Monitorimi	22.7	<p>Menaxheri i projektit obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar.Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.</p>
Parapagimi	22.8	<p>Shuma e parapagimit (avans) : 0</p>



Mbajtja e Parase	22.9	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	22.10	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e furnizimeve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara.
Furnizimet pas shitjes	23.1	Furizimi do të kryhet – transportohen deri te <b>INSTITUCIONËT ARSIMORE TE KOMUNES.</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Mundesisht ne mes te dy palëve..
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtım me ligjin në Kosovë.
Mbikëqyrja	31.0	Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Furnizime shtesë	31.1	
Pagesat	31.2	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për shërbimet e kryera mujore.
Dorëzimi i dokumentave	31.3	Zyrtari për pagesë para se t'i kryej pagesat duhet të bindet se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: <b>Plani i menaxhimit të kontratës</b> , aktvendimet, procesverbalet, raportet, pranimet, urdhëresat, faturat, shkresat, etj.
Arkimi i dokumentave	31.4	Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimit dhe kontratës pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen tek Zyrtarja për rexhistrimin e pasurisë.
Ilyrja në fuqi	31.5	Kontrata hynë në fuqi me <b>MENJEHRE PAS NENSHKRIMI TE</b> Kontrates hartohet në 2 kopje origjinale.




Bashkangjitur: Oferta financiare e artikujve ushqimor.




Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	<b>GEZIM HAJDINI</b>	Emri:	<b>BEHAR RAMA</b>
Pozita:	<b>ZPP</b>	Pozita:	<b>DREJTOR</b>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<b>30.08.2023</b>	Data:	<b>30.08.2023</b>
Vula:		Vula:	




## FURNIZIMI ME MJETE KONKRETIZIMI PER SHKOLLA




### SPECIFIKACIONI I PAISJEVE DHE MATERIALIT PER KABINETIN E BIOLOGJISE




Nr.	Përshkrimi	Specifikimi teknik	Foto	Njësia matëse	Sasia	Çmimi per njësi	Çmimi total me TVSH
1	Skelet standard 170 cm	<p>Dimensione: 170x46x29 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i skeletit standard të njeriut 170 cm. Janë paraqitur 200 eshtra në madhësi natyrore, kafka në tri pjesë dhe dhëmbë të futur veçmas. Është i vendosur në një mbajtëse me bazament. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	255.00	1530.00
2	Skelet 85 cm	<p>Dimensione: 85x20x13 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i skeletit të njeriut 85 cm, i vendosur në një mbajtëse metalike me bazament plastik. Është bërë prej plastike</p>		cop	10	72.00	720.00




3	<p>Modeli skeleti 45 cm me vena dhe arterie</p>	<p>Dimensione: 45x20x13 cm Përshkrimi: Modeli i skeletit të njeriut 45 cm në të cilin jepen eshtrat e trupit dhe të kafkës, kurse në anën e majtë të skeletit janë paraqitur venat dhe arteriet. Është bërë prej plastike, është vendosur në një mbajtëse me bazament</p>		cop	6	82.00	492.00
4	<p>Skelet 42 cm</p>	<p>Dimensione: 42x12x12 cm Përshkrimi: Modeli i skeletit të njeriut 42 cm, vendosur në një mbajtëse metalike me bazament plastik. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	35.00	210.00
5	<p>Shtyllë kurrizore elastike me kafkë dhe komblik</p>	<p>Dimensione: 144x18x12 cm Përshkrimi: Modeli e tregon strukturën e kokave të shtyllës kurrizore, të kafkës dhe të komblikut. Është bërë prej plastike. Është vendosur në një mbajtëse me bazament.</p>		cop	6	55.00	330.00



6	<p>Kafkë e një njeriut të rritur</p>	<p>Dimensione: 22x11x15 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli i kafkës së një njeriu të rritur në madhësi të pamjeve reale. Përbëhet nga dy pjesë. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	58.00	348.00
7	<p>Prerje e kombikut të mashkullit – femrës</p>	<p>Dimensione: 12x12x28 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli 3D i kombikut. Është bërë në dimensione sa gjysha e natyrale. Është bërë prej plastike, është vendosur në bazament metalik</p>		cop	6	48.00	288.00
8	<p>Truri i madh me arterie</p>	<p>Dimensione: 17x17x13 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli i trurit të madh me arterie, në madhësi të pamjeve reale. Përbëhet nga shtatë pjesë. Është bërë prej plastike.</p>		cop	8	62.00	496.00



9	<p>Nyje gjuri me ligamente</p>	<p>Dimensione: 25x15x15 cm Përshkrimi: Model i një pjese të kockës së kofshës dhe asaj të nën gjurit me ligamente të gjurit. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	30.00	180.00
10	<p>Këmbë me enët e gjakut</p>	<p>Dimensione: 98x13x15 cm Përshkrimi: Model këmbë i cili i përmban kockat e këmbës me nyjat e lëvizshme, venat dhe arteriet. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	50.00	300.00
11	<p>Dorë me enët e gjakut</p>	<p>Dimensione: 64x14x15 cm Përshkrimi: Model dorë me nyjën e lëvizshme, venat dhe arteriet. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	50.00	300.00




12	Syri	<p>Dimensione: 14x9,5x10 cm</p> <p>Përshkrimi: Model syri i përbërë nga gjashtë pjesë. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	35.00	210.00
13	Model për demonstrimin e funksionimit të syrit të njeriut	<p>Dimensione: 36x35x11 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga kokërdhoku i syrit – prerje horizontale dhe një thirrëz fleksibel e cila lëviz nëpër shina metalike me mundësi fokusimi të një imazhi të caktuar. Pjesa e sipërme e syrit dhe struktura e brendshme mund të nxirren për t'u parë. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	70.00	420.00
14	Model i zgavres së hundës	<p>Dimensione: 15x20x30 cm</p> <p>Përshkrimi: Model tri herë më i madh se madhësia normale ku janë paraqitur zgavra e hundës, septumi dhe guaskat e hundës. Një pjesë e epiletit mund të mënjanohet. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	42.00	252.00




15	Prejje e veshit	<p>Dimensione: 32x20x20 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli i përbërë nga pjesa e jashtme, e mesme dhe e brendshme e veshit (mund të ndahen veçmas kudhira dhe yzengjia). Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	45.00	270.00
16	Nofulla me dhëmbë dhe qiellzë	<p>Dimensione: 12x13x13 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli nofulle me dhëmbë dhe qiellzë. Nofulla hapet e mbyllet për një vizualizim më të mirë. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00
17	Modeli i nofules së poshtme të majtë	<p>Dimensione: 33x19x18 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli përfaqëson gjysmën (e majtë) e nofules së poshtme, me pjesë që mund të hiqet që të mund të shihen rrënjët e dhëmbëve dhe nervat. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	75.00	450.00




18	<p>Model dhëmbësh</p>	<p>Dimensione: Minimum 30x11x12 cm</p> <p>Përshkrimi: Set dhëmbësh: dhëmballë, dhëmbë prerës, dhëmb qeni. Çdo model dhëmbi është i përbërë nga dy pjesë në të cilat shihet prerja tërthore e dhëmbit. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	78.00	468.00
19	<p>Model dhëmballe me enë gjaku dhe nerva</p>	<p>Dimensione: 16x20x32 cm</p> <p>Përshkrimi: Model dhëmballe i përbërë nga dy pjesë, në të cilat shihen enët e gjakut dhe nervat e dhëmbit. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00
20	<p>Model fyti</p>	<p>Dimensione: 22x11x15 cm</p> <p>Përshkrimi: Model fyti në madhësi reale i përbërë nga dy pjesë. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	42.00	252.00




21	Model lekure	<p>Dimensione: 25x23x4 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i prerjes tenhore të lëkurës. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	45.00	270.00
22	<p>Trupi i njeriut – torzo 85 cm</p>	<p>Dimensione: 47x28x85 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i një trupi të madh njerëzor (85 cm) në madhësi natyrore, i përbërë prej 18 pjesësh. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	8	145.00	1160.00
23	<p>Trupi i njeriut torzo 45 cm</p>	<p>Dimensione: 19x14x45 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i një trupi të vogël njerëzor (45 cm) në madhësi natyrore, i përbërë prej 14 pjesësh. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	68.00	408.00




24	Muskulatura e trupit të njeriut 85 cm	<p>Dimensione: 47x28x85 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i trupit të njeriut (85 cm) në të cilin është paraqitur muskulatura e njeriut. Përbohët prej 4 pjesësh ku tregohen muskujt sipërfaqësorë dhe ato të brendshëm, enët e gjakut dhe nervat. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	95.00	570.00
25	Model njeriu – kukull për demonstrim dhe për ushtrime	<p>Dimensione: 42x21x168 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i dizajnuar në mënyrë speciale për trajnim profesional – praktik të infermierëve për kujdesin ndaj të sëmurit. Përshin: larjen e kokës e të fytyrës, syve e veshëve, mirëmbajtjen e gojës dhe të zgavrës së hundës, frymëmarrje artificiale, vendosjen e infuzionit, mundësi për të bërë injeksione, transfuzion etj.</p>		cop	6	400.00	2400.00




26	Sistemi i qarkullimit te gjakut Zemra Mushkerite Mejçise Shprekë Veshkat e montuara ne baze Madhesia: 80*30*6cm"		cop	6	150.00	900.00
27	Model hipertensioni Dimensione: 38x12x12 cm Pershkrimi: Model i perberë nga glysma e trurit, modeli i syrit, modeli i zemrës dhe modeli i veshkës të vendosura në një mbështetëse metalike. Është bërë prej plastike.		cop	6	80.00	480.00
28	Zemër e re ne 4 pjesë Dimensione: 24x15x15 cm Pershkrimi: Model i një zemre të re të përbërë nga: arteria pulmonare dhe aorta, valvulat, muri ndarës i barkushëve, barkushja e matë dhe ajo e djathtë dhe muskulli i zemrës. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.		cop	6	45.00	270.00



<p>29</p> <p>Zemër e madhe në 3 pjesë</p>	<p>Dimensione: 38x20x15 cm</p> <p>Përshkrimi: Në model janë treguar: arteria pulmonare dhe aorta, valvulat, muri ndarës i barkushëve, barkushja e majtë dhe ajo e djathtë dhe muskulli i zemrës.</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>70.00</p>	<p>420.00</p>
<p>30</p> <p>Model për demonstrimin e punës së zemrës dhe të qarkullimit të gjakut</p>	<p>Dimensione: 41x17x71 cm</p> <p>Përshkrimi: Model elektrik për demonstrimin e qarkullimit të gjakut dhe të punës së zemrës. Zërra është bërë prej materiali elastik, kështu që mund të demonstrohen rrahjet e zemrës, hapja dhe mbyllja e valvulave, ndërsa qarkullimi i gjakut është përfaqësuar me drtë të kuqe dhe të kaltër, d.m.th. arteriet dhe venat. Është bërë orndalshkullie. Punon me energji</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>280.00</p>	<p>1680.00</p>
<p>31</p> <p>Model për demonstrimin e qarkullimit të gjakut</p>	<p>Dimensione: 35x90x8 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli elektrik përfaqëson diagram të punës së zemrës dhe të qarkullimit të gjakut, ndërsa qarkullimi i gjakut është përfaqësuar me drtë të kuqe dhe të kaltër, d.m.th. venat dhe arteriet. Është bërë prej plastike. Punon me energji elektrike në 220 V, 50 Hz.</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>280.00</p>	<p>1680.00</p>




32	Demonstrues i mushkërive	<p>Dimensione: 20x18x28 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga një enë qelqi në të cilën ka dy tullumbace në formë të mushkërive, nëpërmjet të cilëve merret një imazh vizual për punën e mushkërive. Është bërë prej qelqi dhe prej plastike.</p>		cop	6	45.00	270.00
33	Mushkëri – transparente	<p>Dimensione: 28x18x32 cm</p> <p>Përshkrimi: Model më i madh se madhësia reale ku duken "pema" bronkiale e të dy krahëve të mushkërive. Është i vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	100.00	600.00
34	Model bronkiole me alveola	<p>Dimensione: 28x25x44 cm</p> <p>Përshkrimi: Model ku është paraqitur prerje e një pjese të bronkiolës në formën e veshit të rrushit, ku gdo kokërr rrushi i përfaqëson alveolat e mushkërive. Është bërë prej plastike ose material ekivalent. Është vendosur në një bazament.</p>		cop	6	50.00	300.00




35	<p>Model per demonstrimin e funksionimit të sistemit respirator</p>	<p>Dimensione: 41x17x71 cm Përshkrimi: Model elektrik me të cilin demonstrohen frymëmarrja me lëvizjen e kraharorit me organet torakale dhe lëvizja e diafragmës. Është bërë prej plastike. Punon me energji elektrike 220 V, 50 Hz.</p>		cop	6	280.00	1680.00
36	<p>Preje e veshkës me gjëndrën limfatike</p>	<p>Dimensione: 30x20x12 cm Përshkrimi: Preje tërthore e veshkës me gjëndrën limfatike. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	35.00	210.00
37	<p>Sistemi gjential urologjik mashkullor</p>	<p>Dimensione: 40x19x12 cm Përshkrimi: Model i përbërë nga veshkat, fshikëza urinare, penisi dhe testikujt. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	50.00	300.00

<p><b>38</b></p> <p>Sistemi gjental urologjik femëror</p>	<p>Dimensione: 40x19x12 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga veshkat, fshikeza urinare, kanalet urinare, mitra me vezoret dhe ligamentet e mitras me arteriet. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>50.00</p>	<p>300.00</p>
<p><b>39</b></p> <p>Pankreasi (mëlçia)</p>	<p>Dimensione: 30x20x12 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga mëlçia dhe zorra dymbëdhjetëgjitore. Përbëhet nga tri pjesë. Është vendosur në bazament. Është bërë prej plastike</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>60.00</p>	<p>360.00</p>
<p><b>40</b></p> <p>Stomaku</p>	<p>Dimensione: 30x20x12 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli përfaqëson prerje tërthore të stomakut në gjendje gastrike. Përbëhet nga dy pjesë. Është bërë prej plastike.</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>40.00</p>	<p>240.00</p>




41	Sistemi i tretës	<p>Modeli i sistemit tretës të njeriut Modeli i sistemit tretës të njeriut në madhësi reale, i cili demonstroi të gjithë sistemin tretës në lehtësim grafik. Karakteristikat e sistemit tretës: hunda, zgavra e gojës dhe faringu, ezofag, trakti gastrointestinal, mëçja me fshkëzën e tëmthit, Pankreasi, Duodeni, zorrët dhe rektumi i sistemit tretës duhet të shprejta. Koloni tërthor dhe murr i perparme i stomakut duhet të jenë të largueshëm nga sistemi tretës për studim të detajuar të anatomisë.</p>		cop	6	150.00	900.00
42	Modeli i zorrës së trashë	<p>Dimensione: 14x10x19 cm Përshkrimi: Modeli përfaqëson preje tërthore të zorrës së trashë, në madhësi normale. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00
43	Modele të ADN-së	<p>Dimensione: 12x12x30 cm Përshkrimi: Modele të ADN-së në të cilat janë paraqitur dy vargje të ADN-së. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00





<p>44</p> <p>Modeli i fazave të zhvillimit të fetusit</p>	<p>Dimensione: 12x12x15 cm</p> <p>Përshkrimi: Set prej 8 modelesh të mitrës me fetus: 3 modele nga tre muajt e parë të zhvillimit të fetusit dhe 5 modele të zhvillimit të embrionit. Fetusit dhe embrioni mund të nxirren për t'u parë. Janë vendosur në një bazament. Janë bërë prej plastike</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>210.00</p>	<p>1260.00</p>
<p>45</p> <p>Modeli i sistemit riprodhues femror</p>	<p>Përshkrimi: Modeli anatomik i mitrës me vezore</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>50.00</p>	<p>300.00</p>





<p>46</p> <p>Modeli i sistemit riprodhues mashkullor</p>	<p>Modeli i sistemit riprodhues të njeriut mashkullor</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>50.00</p>	<p>300.00</p>
<p>47</p> <p>Modele të organeve qelizore</p>	<p>Dimensione: 27x20x17 cm</p> <p>Pershkrimi: Seti përmban: një model kloroplasti, një model të sistemit të Golxhit, një model mitokondrie dhe dy copë nga trupi i brendshëm dhe ai qendror. Është bërë prej plastike</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>60.00</p>	<p>360.00</p>
<p>48</p> <p>Modeli i membranës qelizore</p>	<p>Dimensione: 30x27x19 cm</p> <p>Pershkrimi: Model në të cilin janë paraqitur shtresa lipide bimolekulare dhe proteinat (të nglyrosura me të kuqe). Është vendosur në një mbashtetëse. Është bërë prej plastike.</p>		<p>cop</p>	<p>6</p>	<p>60.00</p>	<p>360.00</p>




49	Model mitoze dhe mejoze	<p>Dimensione: 40x60 cm</p> <p>Përshkrimi: Set prej dy modelesh të mitozes dhe mejozes me të cilat jepet ndarja e qelive të qelizave të kafshëve. I përshihin fazat e mëposhtme: interfazë, para-profazë, profazë, para-metfazë, metafazë, anafazë, telofazë, citokinezë. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	200.00	1200.00
50	Model qelize shtazore	<p>Dimensione: 50x27x10 cm</p> <p>Përshkrimi: Prerje tërthore e qelizës shtazore. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	60.00	360.00
51	Autopsi e një bretkose	<p>Dimensione: 38x35x15 cm</p> <p>Përshkrimi: Model 3D në të cilin është paraqitur autopsi e pjesës së barkut të një bretkose. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	65.00	390.00



52	Pajisje për autopsi	<p>Dimensione: 15x10x1 cm</p> <p>Përshkrimi: Seti përmban 2 lloje gërshërësh me dimension 12 cm, dy lloje thikash me dimension 12 cm, 2 lloje bizash me dimension 13 cm dhe dy lloje pincetash me dimension 12 cm, janë bërë prej metali.</p>		cop	6	27.00	162.00
53	Hidra (set 2 modele	<p>Dimensione: 39x15x15 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga dy pjesë – prerje gjatësore dhe tërthore, ku tregohet struktura e brendshme dhe ajo e jashtme. Është vendosur në njëbazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	50.00	300.00
54	Paramecium	<p>Dimensione: 20x38x10 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli i organizmi njëqelizor. Përbëhet nga bërthama, vakuola-querpikët e kontaktit dhe të ushqimit. Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00




55	<p>Model aminoacidi në zinxhirin polipeptid</p>	<p>Dimensione: 17x15x24 cm Përshkrimi: Model për demonstrimin e reaksionit kimik të aminoacidit – formimi i lidhjes peptide e cila mundëson lidhjen e dy aminoacideve dhe më tej formimin e zinxhirit polipeptid. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	35.00	210.00
56	<p>Model i virusit të SIDA-s</p>	<p>Dimensione: 26x26x30 cm Përshkrimi: Model i zmadhuar një milion herë, përbëhet nga dy pjesë, ku janë paraqitur membranat e jashtme lipide me strukturë të proteinave dhe bërthama e brendshme e cila e përmban materialin e trashëgimisë virale.</p>		cop	6	60.00	360.00
57	<p>Kërcell i një bime një-kotiledone</p>	<p>Dimensione: 10x40x40 cm Përshkrimi: Model i kërcellit të një bime një-kotiledone, ku është paraqitur struktura qelizore e brendshme dhe e jashtme. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	45.00	270.00




58	Kërçell i një bime dy-kotiledone	<p>Dimensione: 16x33x20 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i kërçellit të një bime dy-kotiledone, ku është paraqitur struktura qelizore e brendshme dhe e jashtme. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	45.00	270.00
59	Struktura qelizore e majës së rrënjës	<p>Dimensione: 45x12x6 cm</p> <p>Përshkrimi: Model ku është paraqitur struktura qelizore e brendshme dhe e jashtme. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	30.00	180.00
60	Struktura e gjetes (model i madh)	<p>Dimensione: 16x45x20 cm</p> <p>Përshkrimi: Në model janë paraqitur struktura e brendshme dhe e jashtme me: epidermën e sipërme dhe të poshtme, qelizat sfungjerore e rrethuese dhe indin vaskular. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	50.00	300.00
61	Model i një qelize bimore	<p>Dimensione: 38x12x12 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i paraqet prerje tërthore reale të një qelize bimore. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	60.00	360.00





62	Lule pjeshke	<p>Dimensione: 20x27x27 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga: pistili, thekët, petalet, gjethet e kupës (sepalet). Është vendosur në një mbështetëse. Është bërë prej plastike</p>		cop	6	30.00	180.00
63	Model i lules së grurit	<p>Dimensione: 38x19x9,5 cm</p> <p>Përshkrimi: Modeli i përbërë nga dy modele: model i lules së grurit dhe model i luleve të kallirit të grurit. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00
64	Model i lules së misrit	<p>Dimensione: 12x12x23 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga: pistili, thekët, petalet, gjethet e kupës (sepalet). Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00
65	Model i lules së patates	<p>Dimensione: 19x19x20 cm</p> <p>Përshkrimi: Model i përbërë nga: pistili, thekët, petalet, gjethet e kupës (sepalet). Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00



66	<p>Model i lules së tulipanit</p>	<p>Dimensione: 25x23x4 cm Përshkrimi: Model i përbërë nga: pistili, thekët, petalet, gjethet e kupës (sepalet). Pistili dhe thekët mund të hiqen për shqyrtim më të hollësishtëm. Është vendosur në një bazament. Është bërë prej plastike.</p>		cop	6	30.00	180.00
